



QENDRA
KINEMATOGRAFIKE
E KOSOVËS

Qendra Kinematografike e Kosovës, në bazë të nenit 14 të Ligjit Nr. 08/L-202 për Kinematografinë dhe Rregullores (MKRS) Nr. 02/2023 për konkurset dhe mbështetjen financiare të veprave filmike dhe audio-vizuale shpall:

**KONKURS PËR FILM TË METRAZHIT TË SHKURTËR BAZUAR NË
MATERIALE ARKIVORE
(deri në 30 minuta)
Ref. Nr. QKK 14/2026**

Qëllimi i kësaj thirrjeje është mbështja e veprave të reja filmike që përdorin materiale arkivore si pjesë të rëndësishme të konceptit, hulumtimit, strukturës narrative apo gjuhës filmike.

Kjo kategori synon të nxisë përdorimin kreativ dhe kritik të trashëgimisë audiovizuale dhe dokumentare, si dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet komunitetit të filmit dhe institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile dhe koleksioneve private që ruajnë materiale arkivore.

Konkursi mbështet projekte dokumentare, eseistike, eksperimentale, hibride apo forma të tjera filmike, për aq kohë sa materiali arkivor përbën pjesë thelbësore të projektit dhe nuk përdoret vetëm si material ilustrues.

Materialet arkivore mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- Materiale filmike dhe televizive;
- Kronika filmike dhe materiale të papublikuara;
- Fotografi;
- Regjistrime zanore dhe radiofonike;
- Arkiva publike dhe institucionale;
- Arkiva private dhe familjare;
- Filma amatorë dhe *home movies*;
- Letra, dorëshkrime, gazeta dhe dokumente të tjera;
- Materiale nga arkivat dhe koleksionet e Kosovës.

Të drejtë konkurimi kanë të gjithë personat juridik, vendas ose të huaj, të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit dhe paraprakisht të regjistruar në QKK dhe që i plotësojnë kushtet e kërkuara me këtë konkurs.

QKK do të lehtësojë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse publike dhe në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e aplikueshme, qasjen e aplikuesve/projekteve të përzgjedhura në arkiva dhe koleksione publike për qëllime të hulumtimit dhe zhvillimit të projektit, kur një qasje e tillë mund të sigurohet në përputhje me rregullat e institucionit përkatës. Të drejtat për përdorimin e materialeve në veprën filmike rregullohen veçmas, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-205 për të

Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, legjislacionin në fuqi për arkivat dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm, si dhe sipas marrëveshjeve me bartësit përkatës të të drejtave.

I. APLIKIMI

Aplikimi bëhet përmes emailit: konkurset.qkk@rks-gov.net

- Në subjektin (Subject) të emailit duhet të shënohet kategoria e aplikimit me numër të referencës dhe emri i projektit, sipas shembullit më poshtë:

Ref. Nr. QKK 14/2026 - Emri i Projektit

Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të bashkëngjiten **si PDF Files veç e veç në email**, sipas renditjes në paragrafin II.

Madhësia totale e të gjitha dokumenteve të bashkëngjitura nuk duhet të tejkalojë 20 MB.

Sqarim:

Në rast se aplikuesi dërgon më shumë se një aplikim për të njëjtin projekt në të njëjtën kategori, vetëm aplikimi i dërguar përmes emailit të parë do të merret parasysh. Brenda 48 orëve, aplikuesi do të pranojë konfirmimin për pranimin e aplikimit.

Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar diskualifikohen, në përputhje me Rregulloren (MKRS) Nr. 02/2023¹ për Konkursin dhe Mbështetjen Financiare të Veprave Filmike dhe Audio-vizuale, Neni 12, pika 1.

Tarifa e aplikimit:

Aplikimi për Konkursin për Film të Metrazhit të Shkurtër Dokumentar kushton 50€ (pesëdhjetë euro).

Mënyra e pagesës së aplikimit:

Fletëpagesa merret në zyret e QKK-së dhe duhet të dorëzohet fizikisht së bashku me konfirmim të pagesës në zyret e QKK-së.

II. DOKUMENTET E KËRKUARA

1. Forma e Aplikimit, së bashku me testin e kulturës (të shkarkohet nga Website i QKK);
2. Biografi dhe filmografi e anëtarëve kryesorë të ekipit (regjisorit, producentit, etj.);
3. Letër motivimi nga regjisor (autori), në të cilën shpjegohet motivimi personal dhe artistik për të punuar me materiale arkivore, si dhe interesi për temën, materialet apo koleksionet që synohen të hulumtohen;
4. Linqet e filmave të mëhershëm të regjisorit dhe producentit;
Pranohet vetëm:
 - Vimeo me password, valid deri në ditën e shpalljes së rezultateve; ose
 - YouTube Unlisted, me link të klikueshëm dhe të integruar (embedded).
5. Koncepti fillestar i projektit, ku përshkruhet ideja, qasja artistike dhe mënyra e mundshme e përdorimit të materialeve arkivore në veprën filmike;

6. Përshkrimi i shkurtër i projektit, duke përfshirë temën, qëllimin dhe drejtimin e mundshëm të hulumtimit duke identifikuar, nëse është e mundur, arkivat, institucionet, koleksionet ose burimet private që synohen të konsultohen;
7. Buxheti i detajuar i projektit, përfshirë fondet e tjera;
8. Buxheti i kërkuar nga QKK (të shkarkohet nga Website i QKK);
9. Vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), që dëshmon se aplikuesi nuk ka obligime tatimore të pashlyera.
10. Dokumente të tjera relevante që mund t'i ndihmojnë aplikimit.

Kujdes: Të gjitha dokumentet duhet të bashkëngjiten veç e veç dhe **madhësia totale e dokumenteve të bashkëngjitura nuk duhet të tejkalojë 20 MB.**

III. KUFIZIMET NË PJESËMARRJE

1. Shtëpitë filmike që janë me vonesë në zbatimin e kontratave paraprake nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
2. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë konkurimi me më shumë se tri projekte brenda konkursit.

Vërejtje - referuar Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit: punëtorët e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit, dhe institucioneve vartëse të saj, nuk kanë të drejtë aplikimi në Konkurs.

Konkursi është i hapur nga data 23.09.2026 deri më 25.10.2026, në orën 00:00.